



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 145 prot.

Kamëz, më 20.11.2023

V E N D I M

Nr. 102.Datë 20/11 2023

MBI

“EMËRTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2023, pasi mori në shqyrtim kërkesën për emërtimin e rrugës “Ramadan Rifat Hasa”, me datë 15.11.2023, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; Këshilli Bashkiak Kamëz”:

V E N D O S I :

- Emërtimin “**Ramadan Rifat Hasa**” rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet
- Ngarkohen Drejtorja e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLBASHI

